



## KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË CËRRIK, MBI REALIZIMIN E PROJEKTIT *“NDËRTIMI I TERMINALIT TË AUTOBUSËVE”*.

### KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE.

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI TEMATIK PËRPUTHSHMËRIE, USHTRUAR NË BASHKINË CËRRIK, MBI REALIZIMIN E PROJEKTIT *“NDËRTIMI I TERMINALIT NË ZONËN KADASTRALE 1389, LAGJIA NR. 2 QYTETI CËRRIK”*, NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 438 PROT, DATË 18.06.2019, *“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË ADOPTIMIT TË TERMINALIT TË AUTOBUSËVE NË VEND-PARKIMI PUBLIK, LULISHTE DHE NDRIÇIM”*.**

Auditimi është kryer në bazë të autorizimit të Auditimit Tematik (Përputhshmërisë) me nr. 420/2, datë 02.08.2019, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ankesës të paraqitur në KLSH me nr. 420 prot, datë 07.06.2019 nga 40 banorë të një blloku të një lagjeje të Bashkisë Cërrik, qyteti Cërrik, përfaqësuar nga Kryesia e Banorëve të Lagjes nr. 2 dhe ankesës së shoqatës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare për Mjedis dhe Gjeoshkencë, administruar në KLSH me nr. 522 prot, datë 17.07.2019.

Auditimi është kryer nga:

1. N. N., Kryeauditues (Përgjegjës grupi)
2. Gj. P., Drejtor i Departamentit
3. A. Z., Kryeauditues
4. R. Xh., Auditues i Lartë

Auditimi ka filluar më 02/08/2019.

Auditimi ka përfunduar më 13/09/2019.

Ky Raport Tematik Auditimi u përgatit nga data 20.09.2019 deri më datë 07.10.2019.

**TIRANË, Tetor 2019**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>FAQE</b>
<b>I. Përmbledhje</b> .....	03-07
<b>II. Hyrje</b> .....	08-09
<b>III. Qëllimi dhe procesi i auditimit</b> .....	09-10
<b>IV. Rezultatet e auditimit</b> .....	11-22
V. Përmbledhje e konstatimeve (shkelje dhe parregullsi).....	22-24
<b>Konkluzionet e auditimit dhe Rekomandimet</b> .....	24-25



## KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

### I. Përmbledhje

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi subjektin Bashkia Cërrrik, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me: Zbatimin e procedurave të miratimit të projektit të investimit publik “*Ndërtimi i terminalit në zonën kadastrale 1389, lagjia nr. 2 qyteti Cërrrik*”, ndryshuar me projektin “*për miratimin e projektit të adoptimit të terminalit të autobusëve në vend-parkimi publik, lulishte dhe ndriçim*”; evidentimin dhe vlerësimin e drejtë të subjekteve që preken nga realizimi i investimit, përcaktimin e vlerës së shpronësimit; dërgimin për miratim të kërkesës për shpronësim; realizimin e procedurave të prokurimit të investimit; procesi i realizimit të tij dhe dokumentacioni i administruar.

Veç kësaj është pasur në qendër të vëmendjes siguria e nivelit të menaxhimit, si dhe transparenca me publikun.

Objektivat kryesore për këto çështje kanë qenë, që nëpërmjet një pune audituese të evidentohen shkeljet dhe parregullsitë ligjore në drejtim të zbatimit të procedurave miratimit të projektit, zhvillimin e procedurës së prokurimit deri në shpalljen e fituesit, lidhja dhe zbatimi i kontratës, si dhe evidentimin e përcaktimit e saktë dhe drejtë të subjekteve që shpronësohen dhe koston e shpronësimit, me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen.

Për këtë auditimi vëmendja u përqendrua në drejtim; të administrimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të projektit “*Ndërtimi i terminalit në zonën kadastrale 1389, lagjia nr. 2 qyteti Cërrrik*”, ndryshuar me projektin “*për miratimin e projektit të adoptimit të terminalit të autobusëve në vend-parkimi publik, lulishte dhe ndriçim*”, nevojave për realizimin e investimit dhe dobishmërinë e tij, miratimin në Këshillin Bashkiak të projektit të investimit, përputhshmëria me Planit e Përgjithshëm Vendor, miratimi apo dhënia e pëlqimit nga institucioneve të tjera jo në varësi të bashkisë që lidhen apo preken nga realizimi i projektit, evidentimin sipas projektit të subjekteve private, pasuritë e të cilëve preken nga projekti, përcaktimi i pasurive për shpronësim, sigurimi i fondeve për shpronësim, prokurimi i zbatimit të investimit, shpallja e ofertës fituese, lidhja e kontratës, ndjekja dhe zbatimi i saj.

Gjatë auditimit të kryer për zbatimin e procedurave për hartimin dhe miratimin e projektit “*Ndërtimi, Rikonstruksioni dhe Rinovimi i Unazës së Vogël, Tiranë*”, vlerësimin të nevojës për realizimin e projektit, evidentimin e subjekteve që preken nga zbatimi i tij, prokurimi i investimit dhe fillimi i zbatimit, nga Bashkia Cërrrik, në mënyrë të përmbledhur rezultoi si më poshtë:

- ✓ Bashkia Cërrrik, në funksion të implementimit të projektit “*Ndërtim i terminalit të autobusëve*”, në dhjetor 2018 ka realizuar procedurën e prokurimit me objekt të llojit “Procedurë e Hapur”, me vlerë të prokuruar prej 11,999,903 pa tvsh, për të cilën është shpallur fitues BOE “V.” & “F.” shpk, për vlerën e kontraktuar prej 11,955,322 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT "NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL".

- ✓ Sipërfaqja e përzgjedhur fillimisht nga Bashkia Cërrik ka pasur një sipërfaqe prej 2524m<sup>2</sup>, truall mbi të kanë rezultuar themele objektesh të ndërtuar me kontribut vullnetar në gjendje të degraduar teknike, po ashtu 2 garazhe pa leje ndërtimi dhe të palegalizuar si dhe disa objekte të vogla të pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie.
- ✓ Nga auditimi i dosjes të projektit rezulton se: Bashkia Cërrik në referim të VKM-së nr. 573, datë 28.05.2019 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrik*", ka filluar realizimin e investimit "Ndërtim Terminali i autobusëve".
- ✓ Pasuritë mbi të cilat do të realizohet investimi rezultojnë në pronësi shtet, kryesisht të emër të bashkisë, por dhe të papërcaktuara, kjo për shkak të realizimit të pasaktë të procesit të inventarizimit të pronave publike dhe shtetërore. Pronat figurojnë në zërin "Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji", dhe lloji i transferimit "Në përdorim".
- ✓ **-Pasuritë e kaluara në pronësi, nuk figurojnë të regjistruara në emër të Bashkisë Cërrik.**
- ✓ Pas procesit të inventarizimit dhe kalimit në pronësi, mbi pronën objekt zhvillimi, ka vepruar edhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, duke bërë legalizimin e disa trojeve dhe objekteve të ndërtuara pa leje, çka ka sjell për pasojë edhe pezullimin e procesit të zbatimit të investimit, pasi rezulton se me konfirmimin nga ZVRPP Elbasan të ekzistencës së titujve të pronësisë, bashkia ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik të trojeve dhe objekteve (edhe pse ato çënojnë në një masë shumë të vogël investimin), detyrim ky i përcaktuar nga ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe akteve të dala në zbatim të këtij ligji.
- ✓ Bazuar në PPV Cërrik objekti realizohet në parcelën me nën njësinë strukturore 1/11 të PPV Cërrik me kategori bazë të përdorimit të tokës "Banim" si dhe kategori të tjera të lejuara të përdorimit të tokës "Shërbime (S)", "Arsim (AS)", "Shëndetësi (SH)", "Argëtim dhe Rekreacion (AR)" si dhe "Infrastrukturë pa detyrim për hartimin e Planit të Detajuar Vendor", duke mos përjashtuar projektimin dhe ndërtimin e investimit.
- ✓ Projekti fillestar është ndryshuar. Shkaku për ndryshimin e projektit, rezulton se gjatë zbatimit të projektit bashkia ka hasur në kundërshtimin e banorëve të 3 pallateve që gjenden në këtë bllok të cilët nuk kanë dashur/lejuar realizimin e këtij investimi, brenda një blloku banimi.
- ✓ -Pas dëgjësës publike me banorët e këtyre tre pallateve nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kryetari i Bashkisë Cërrik, me vendimin nr. 197/1 prot, datë 29.05.2019, ka urdhëruar hartimin e ndryshimeve në projekt me qëllim heqjen e funksionit të këtij projekti nga ndërtim Terminali në parkim publik për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

autovetura, gjelbërim dhe ndriçim, pra kthimin e këtij sheshi në shesh funksional për banorët e këtyre pallateve si dhe për banorët e qytetit.

- ✓ Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka kërkuar nga studio projektuese, hartuese e këtij projekti të bëjë rishikimin e tij në përputhje me funksionin e ri që do të kryejë ky investim, projekt i cili pasi është adoptuar në shesh parkimi publik, lulishte dhe ndriçim, rezulton i miratuar në Këshillin Bashkiak të Bashkisë me vendim nr. 438 prot, datë 18.06.2019 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 279/1 prot, datë 05.07.2019.
- ✓ Zhvillimi i ri kryhet përgjithësisht në truallin me status juridik shtet me përjashtim të sipërfaqes prej 126.26 m<sup>2</sup> e cila është me status juridik truall dhe objekte në pronësi private.
- ✓ Rishikimi i projektit është referuar në VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 17 "Ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit" si dhe Rregullores e PPV neni 53 "Sipërfaqe e gjelbërimit publik në Zonë", neni 55 "Ndërtimi i vendparkimeve"/
- ✓ -Për këtë objekt është marrë Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit të Mjedis, në Prill 2019, nga studio “Job Project” shpk, raport i ncjerrë për projektin fillestar “Ndërtim i terminalit të linjave të transportit urban dhe interurban me autobusa të udhëtarëve”, si dhe Leja Zhvillimore nr. 135, datë 17.04.2019, me emërtimin “Ndërtim i terminalit të linjave të transportit urban dhe interurban me autobusa të udhëtarëve”.
- ✓ -Pas nënshkrimit të kontratës me sipërmarrësin zbatues të projektit dhe ndryshimit të destinacionit të tij të miratuar edhe në Këshillin Bashkiak Cërrrik, nga “Ndërtim i terminalit të linjave të transportit urban dhe interurban me autobusa të udhëtarëve” në destinacionin final “Për miratimin e projektit të adoptimit të terminalit të autobusëve në vend-parkimi publik, lulishte dhe ndriçim”, Bashkia Cërrrik, duhet të kishte miratuar ndryshimin e emërtimit të lejes zhvillimore, në përputhje me përcaktimit e ligjit nr. 107/2014, datë 01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017, dhe konkretisht, nenit 24 pika 5 dhe 6. Mos pajisja me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e nenit 38 “Leja e zhvillimit”, të ligjit nr. 107/2014, datë 01.10.2014.
- ✓ - Sipas Regjistrit të parashikimit të prokurimeve, dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) me shkresën nr. 18/1 prot, datë 03.01.2018, procedura me objekt “Ndërtim i terminalit të autobusëve” ka qenë programuar për t’u zhvilluar në muajin mars 2018, por zhvilluar në dhjetor 2018.
- ✓ Lidhur me dokumentet e këtij tenderi të pasqyruara në sistemin elektronik SEP, janë konstatuar se:
- ✓ 1. Në pikën 1.3.5 të kapacitetit teknik, në lidhje me stafin, ndër të tjerë, AK ka kërkuar që ofertuesit të disponojnë edhe: “Një inxhinier gjeolog”, kriter ky i cili nuk gjen argumentim edhe pse nga NJP është sqaruar se vendosja e këtij kriteri është bërë për shkak të të qenurit të zonës së Bashkisë Cërrrik, pjesë të pellgut



## KONTROLLI I LARTË I SHITIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

ujëmbajtës Dumre-Sulovë dhe rreziqeve të mundshme gjeologjike gjatë zbatimit të punimeve.

- ✓ *Bazuar në: Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet; Zërat e punimeve të parashikuara në Preventiv; Veprimtaritë dhe detajet e përshkruara në dokumentet teknike të kësaj procedure; ngjashmërinë e profileve të inxhinierëve të ndërtimit dhe hidroteknik në kuptim të punimeve që do të kryhen, arsyetohet se për zbatimin e punimeve apo veprimtarive, do të ishte e mjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierit të ndërtimit.*
- ✓ *Gjithashtu, për zbatimin e punime për ekzekutimin e kontratës, APP vlerëson se AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari për të cilat do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit gjeolog.*
- ✓ *2. Kriteret e veçanta të vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës në kundërshtim me ligjin. Kjo pasi janë kërkuar në mënyrë të ekzagjeruar:*
- ✓ *7 inxhinierë; fabrikë prodhimi betoni dhe linjë për prodhimin e inerteve, si dhe 6 licenca dhe me dhjetëra standarde, kur objekt tenderimi është sistemim sheshi për parkim për 20 ditë për një sipërfaqe prej 1840 m<sup>2</sup>.*
- ✓ *Bazuar në sa më sipër, si dhe në rekomandimin e APP, NJP ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pasi kriteret e vendosur nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që kërkohet të zbatohet.*
- ✓ *3. Megjithëse tenderi është vendosur të zhvillohet me 31.12.2018, financimi është programuar tre vjeçar me shpërndarje: 20% në vitin 2018, 40 % në 2019 dhe 40 % në vitin 2020.*
- ✓ *Likuidimi prej 20 % të kontratës, kur tenderi zhvillohet ditën e fundit të këtij viti, jo vetëm që është pakuptim, por i krijon favore kontraktorit dhe vështirësi financiare bashkisë për të likuiduar në vitin 2019 60% të vlerës së kontratës.*
- ✓ *Nga dosja teknike rezulton se projekti dhe preventivi i objektit “Ndërtim Terminali i autobuzëve”, është hartuar nga shoqëria “D.” shpk në Nëntor 2018. Vlera e preventivit është **11,999,903 lekë** pa tvsh.*
- ✓ *Sipas projektit sipërfaqja që zhvillohet është 2136 m<sup>2</sup>, nga të cilat 2080 m<sup>2</sup> sipërfaqe e shtruar me pllaka (në preventiv ky zë është me asfaltobeton) dhe 56 m<sup>2</sup> sipërfaqja e murit rrethues + sipërfaqja e porterisë + nyja sanitare. Sipas azhurnimit topografik të objektit, rezulton se distancat nga objektet kufitarë janë 7.6 m me pallatin 5 katësh nga veriu me nr. 87, 14.35 m me pallatin 5 katësh nga lindja me nr. 85, 6.06 m nga pallati 5 katësh nga juglindja me nr. 86 dhe 1.81 m nga godina njëkatëshe nga jugu. Nga përditimi kufizohet nga rruga ekzistuese.*
- ✓ *Pas ankesave të qytetarëve me VKB-së nr. 438, datë 18.06.2019, është bërë ndryshimi i destinacionit të objektit dhe miratimi i projektit të adoptimit, nga objekti “Ndërtimi i Terminalit të autobuzëve”, në objektin “Vendparkim publik, lulishte dhe ndriçim”.*



## KONTROLLI I LARTË I SHITIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

- ✓ Projekti dhe preventivi i ripunuar (dhe i miratuar) është hartuar po nga shoqëria “Derbi E” shpk në muajin Qershor 2019.
- ✓ Vlera e këtij preventivi të ripunuar, pas negocimit për çmimet e reja, është **11,955,291 lekë** pa TVSH. Në këtë preventiv janë parashikuar 10 kapituj.
- ✓ Sipas këtij projekti, sipërfaqja që zhvillohet është 1850 m<sup>2</sup>, nga të cilat 1442 m<sup>2</sup> sipërfaqe e shtruar me pllaka dhe 56 m<sup>2</sup> sipërfaqja e murit rrethues + sipërfaqja e porterisë + nyja sanitare, gjelbërimi me sipërfaqe 329 m<sup>2</sup>. Sipas azhurnimit topografik të objektit, rezulton se distancat nga objektet kufitarë janë 13.13 m me pallatin 5 katësh nga veriu me nr. 87, 16.5 ml dhe 18.7 ml me pallatin 5 katësh nga lindja me nr. 85, 10.08 m nga pallati 5 katësh nga juglindja me nr. 86 dhe 2.22 ml dhe 2.65 ml nga godina njëkatëshe nga jugu. Nga perëndimi kufizohet nga rruga ekzistuese.
- ✓ Nga krahasimi i këtyre dy projekteve, rezulton se:
  - Ka ndryshuar lartësia e murit rrethues nga 1.0 m, në 0.6 m;
  - Kanë ndryshuar (janë rritur) distancat ndaj objekteve ekzistuese;
  - Është ndryshuar paketa e shtresave të sheshit nga asfalt në pllaka betoni;
  - Është shtuar kapitulli i gjelbërimit
  - Është shtuar kapitulli i ndërtimit të rrugëve hyrëse-dalëse për në parkim;
  - Është shtuar kapitulli i vendosjes së sinjalistikës në parkim.
  - Analizat e çmimeve janë marrë sipas manualit të çmimeve për zërat që gjenden në manual dhe janë bërë analizat për ato zëra që mungojnë në manual.
- ✓ Nga verifikimi i situacionit pjesor nr. 1, datë 28.04.2019 dhe faturë tatimore datë 03.06.2019, rezulton se janë situacionuar punime me vlerë **3,991,142 lekë** (likuiduar 3,678,084 lekë).
- ✓ Nga auditimi i këtij situacioni dhe verifikimi në objekt, i kryer nga grupi i auditimit në prani edhe të Drejtorit të Planifikimit dhe Rregullimit Territorit, Bashkia Cërrik, ka rezultuar se:
  - Janë kryer punimet e murit rrethues, por janë situacionuar zërat e gërmimit të rrethimit, themelit të betonit, murit të betonit, kolonave të betonit dhe hekurbetonit me  $d = 8 \text{ mm}$ , më shumë se sasia e preventivuar në vlerën 270,375 lekë;
  - Është situacionuar punimi i pakryer në kapitullin “Punime për ndërtimin e tualetit”, me vlerë 218,152 lekë;
  - Janë respektuar distancat e parashikuara në projektin e adoptuar.
  - Punimet e ndërtimit janë ndërprerë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

### II. Hyrja:

Përshkrimi i çështjes që auditohet:

Auditim mbi miratimin nga Këshilli Kombëtar i Territorit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) për Bashkinë Cërrrik. Përfshirja dhe evidentimi në PPV i segmentit “Ndërtimi i terminalit në zonën kadastrale 1389, lagjia nr. 2 qyteti Cërrrik”.

Hartimi dhe Miratimi nga Bashkia Cërrrik e Planit të Detajuar Vendor (PDV), për zonën në të cilën përfshihet projekti.

Miratimi nga Këshilli Bashkiak i Projektit të Investimit Infrastrukturor “Ndërtimi i terminalit në zonën kadastrale 1389, lagjia nr. 2 qyteti Cërrrik”, Miratimi nga Këshilli Teknik dhe Kryetari i Bashkisë të Lejes Zhvillimor për Investimin.

Hartimi i Raportit mbi Vlerësimin dhe Ndikimin në Mjedis.

Evidentimin e nevojës për realizimin e procedurave ligjore për Shpronësimin për Interes Publik. Përcaktimi i objekteve për të cilat kërkohet shpronësim, evidentimi i pronarëve të cilët preken nga Investimi.

Ngritja e Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit, dokumentimi i procedurave dhe dokumentacionit mbi përcaktimin e parcelave për të cilat nevojitet shpronësimi, verifikimi në terren i trojeve dhe objekteve, korrespondenca me Drejtorinë Rajonale të ASHK Elbasan mbi titujt e pronësisë të parcelave dhe objekteve që preken nga investimi dhe objektet në proces legalizimi

Bërja me dije e subjekteve private të cilat preken nga realizimi i investimit, mbi fillimin e procedurave të shpronësimit dhe koston financiare respektive, për secilin subjekt.

Auditim mbi fondet në dispozicion dhe burimin e investimit për realizimin e projektit, hartimi i projekteve dhe preventivave, përcaktimi i vlerës të përlllogaritur të kontratës, hartimi i kriterëve për kualifikim, zhvillimi i procedurës së prokurimit. Lidhja e kontratës.

Realizimi i dëgjësave publike me palët e interesuara dhe veçanërisht banorët e zonës në të cilën do të realizohet projekt/investimi.

Sipas drejtimeve të Autorizimit të Auditimit Tematik nr. 420/2, datë 02.08.2019, ndryshuar me programin nr. 240/2 dhe 3, datë 17.03.2016, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përputhje me: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligji nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10258, datë 25.03.2010, Aktin normativ nr. 4, datë 25.8.2010 (miratuar me ligjin nr. 10315, datë 16.9.2010), ligjin nr. 10360, datë 16.12.2010, ligjin nr. 22/2013 dhe nr. 110/2013, datë 01.04.2013, si dhe ligji aktual nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligji nr. 183/2014 “Për disa ndryshime dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për Inspektimin e Ndërtimit”, të ndryshuar; ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

Gjendja aktuale e çështjes së shqyrtuar është në fazën kur nga grupi i auditimit është mbajtur aktkonstatimin nr. 1, datë 13.09.2019 dhe aktverifikimin nr. 1, datë 13.09.2019, akte për të cilat Bashkia Cërrrik me shkresën nr. 2581 prot, datë 20.09.2019, ka paraqitur kundërshtimet përkatëse, të cilat gjejnë pasqyrim në këtë Raport Auditimi Tematik të përgatitur, i cili i paraqitet subjektit të audituar për njohje e zbatim.

### **III. Qëllimi dhe procesi i auditimit**

Subjekti i audituar: **Bashkia Cërrrik.**

*Çështjet e audituara:*

Auditim mbi fondet në dispozicion dhe burimin e investimit për realizimin e projektit, hartimi i projekteve dhe preventivave, përcaktimi i vlerës të përlllogaritur të kontratës, hartimi i kriterëve për kualifikim, zhvillimi i procedurës së prokurimit. Lidhja e kontratës.

Auditim mbi miratimin nga Këshilli Kombëtar i Territorit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) për Bashkinë Cërrrik. Përfshirja dhe evidentimi në PPV i segmentit “Ndërtimi i terminalit në zonën kadastrale 1389, lagjia nr. 2 qyteti Cërrrik”.

Hartimi dhe Miratimi nga Bashkia Cërrrik e Planit të Detajuar Vendor (PDV), për zonën në të cilën përfshihet projekti.

Miratimi nga Këshilli Bashkiak i Projektit të Investimit Infrastrukturor “Ndërtimi i terminalit në zonën kadastrale 1389, lagjia nr. 2 qyteti Cërrrik”, Miratimi nga Këshilli Teknik dhe Kryetari i Bashkisë të Lejes Zhvillimor për Investimin.

Hartimi i Raportit mbi Vlerësimin dhe Ndikimin në Mjedis.

Evidentimin e nevojës për realizimin e procedurave ligjore për Shpronësimin për Interes Publik. Përcaktimi i objekteve për të cilat kërkohet shpronësim, evidentimi i pronarëve të cilët preken nga Investimi.

Ngritja e Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit, dokumentimi i procedurave dhe dokumentacionit mbi përcaktimin e parcelave për të cilat nevojitet shpronësimi, verifikimi në terren i trojeve dhe objekteve, korrespondenca me Drejtorinë Rajonale të ASHK Elbasan mbi titujt e pronësisë të parcelave dhe objekteve që preken nga investimi dhe objektet në proces legalizimi

Bërja me dije e subjekteve private të cilat preken nga realizimi i investimit, mbi fillimin e procedurave të shpronësimit dhe koston financiare respektive, për secilin subjekt.

Realizimi i dëgjësive publike me palët e interesuara dhe veçanërisht banorët e zonës në të cilën do të realizohet projekt/investimi.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT "NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL".

**Objektivat e auditimit:** Zbulimi i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, Ligjshmërisë, Efiçensës, Efektivitetit dhe Ekonomicitetit, me qëllim që për rastet individuale të identifikuar të detyrohen personat përgjegjës të mbajnë përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH<sup>-së</sup>, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën është realizuar projekti në tërësi, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave të paraqitura, konkludojmë se krahas punës së bërë, evidentohen dhe të meta e mangësi në zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të cilat gjerësisht janë trajtuar në këtë Projekt Raport Auditimi Tematik të paraqitur.

**Kriteret e vlerësimit:** Vërtetësia, përputhshmëria, ligjshmëria dhe rregullshmëria e veprimtarisë mbi hartimin dhe miratimin e projektit, koston financiare të tij, evidentimin dhe përcaktimin e pasurive që preken nga investimi, si dhe prokurimi dhe realizimi i investimit.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;
- procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
- nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
- anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
- ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe;
- shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve;
- vlerësimin me objektivitet, profesionalizim dhe paanshmëri i observacioneve të paraqitura nga subjekti audituar.

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet, duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, konform me parimit, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

### **IV. Rezultatet e auditimit, paraqiten si më poshtë:**

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH<sup>së</sup>, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën ishin kryer veprimet për realizimin e procesit të shpronësimit nga bashkia, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave të paraqitura, *konstatohet se:*

Bashkia Cërrik, në funksion të implementimit të projektit “Ndërtim i terminalit të autobusëve”, në dhjetor 2018 ka realizuar procedurën e prokurimit me objekt të llojit “Procedurë e Hapur”, me vlerë të prokuruar prej 11,999,903 pa tvsh, për të cilën është shpallur fitues BOE “V.” &”F.” shpk, për vlerën e kontraktuar prej 11,955,322 lekë, dhe lidhur kontrata me nr. 1661 prot, datë 02.05.2019.

#### **I. Lidhur me truallin mbi të cilin do të realizohet investimi, është konstatuar se:**

Sipërfaqja e përzgjedhur fillimisht nga Bashkia Cërrik ka pasur një sipërfaqe prej 2524m<sup>2</sup>, truall mbi të kanë rezultuar themele objektesh të ndërtuar me kontribut vullnetar në gjendje të degraduar teknike, po ashtu 2 garazhe pa leje ndërtimi dhe të palegalizuar si dhe disa objekte të vogla të pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie.

Nga auditimi i dosjes të projektit rezulton se: Bashkia Cërrik në referim të VKM-së nr. 573, datë 28.05.2019 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrik”, ka filluar realizimin e investimit “Ndërtim Terminali i autobusëve”.

Pasuritë mbi të cilat do të realizohet investimi rezultojnë në pronësi shtet, kryesisht të emër të bashkisë, por dhe të papërcaktuara, kjo për shkak të realizimit të pasaktë të procesit të inventarizimit të pronave publike dhe shtetërore. Pronat figurojnë në zërin “Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji”, dhe lloji i transferimit “Në përdorim”.

**-Pasuritë e kaluara në pronësi, nuk figurojnë të regjistruara në emër të Bashkisë Cërrik.**

Pas procesit të inventarizimit dhe kalimit në pronësi, mbi pronën objekt zhvillimi, ka vepruar edhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, duke bërë legalizimin e disa trojeve dhe objekteve të ndërtuara pa leje, çka ka sjell për pasojë edhe pezullimin e procesit të zbatimit të investimit, pasi rezulton se me konfirmimin nga ZVRPP Elbasan të ekzistencës së titujve të pronësisë, bashkia ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik të trojeve dhe objekteve (edhe pse ato çënojnë në një masë shumë të vogël investimin), detyrim ky i përcaktuar nga ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT "NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL".

*përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*", nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe akteve të dala në zbatim të këtij ligji.

Nga korrespondencat e Bashkisë me ASHK Drejtoria Vendore Elbasan, gjendja juridike e pasurive të ndodhura në zonën kadastrale 1389, të cilat preken nga realizimi i investimit janë si vijon:

1. Pasuria Nr.2.39 me sip. 208 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  2. Pasuria Nr. 2.40 me sip.713 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  3. Pasuria Nr. 2.74 me sip.135 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  4. Pasuria Nr. 2.180 me sip. 1026 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  5. Pasuria Nr. 2.183 me sip. 33 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  6. Pasuria Nr. 2.184 me sip. 39 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  7. Pasuria Nr. 2.197 me sip. 624 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  8. Pasuria Nr. 2.198 me sip. 405 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  9. Pasuria Nr. 2.220 me sip.1019.30 m<sup>2</sup>, me pronar Shtet;
  10. Pasuria Nr. 2.45 Nd. me sip.22.16 m<sup>2</sup>, me pronar H. Sh. Q.;
  11. Pasuria Nr. 2.221 Tr. me sip.68.1 m<sup>2</sup>, me pronar H. Sh. Q.;
  12. Pasuria Nr. 2.93 me sip. 36 m<sup>2</sup>, me pronar S. I. B..
- (trajtuar më hollësisht në aktkonstatimin nr. 1, datë 13.09.2019).

### **II. Mbi përgatitjen së detyrës së hartimit të projektit dhe të zbatimit.**

Bashkia Cërrik, rezulton se në hartimin e detyrës së projektimit kanë pasur për referim Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 "Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor", neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë" pika c; Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 neni 4/1 "Hapësira publike", neni 5 "Autoritetet përgjegjëse të planifikimit" paragrafi 1/3 pika b neni 12 "Përgjegjësitë e Këshillit Bashkiak" paragrafi 2 pika c dhe ç. Seksioni II "Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit" pika 2 neni 29 "Përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë"; VKM nr.408, datë 13.05.2015 neni 17 "Ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit" neni 21 "Shqyrtimi i kërkesave për lejeve nga autoriteti vendor" neni 10 "Leja e zhvillimit" neni 11 "Leje e ndërtimit", Planin e Përgjithshëm Vendor si dhe Rregulloren përkatëse miratuar me Vendimin nr.150, datë 29.12.2016, vendimin e KKT nr. 11, datë 08.02.2017, si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 446, datë 10.05.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë Terminali i Autobuzeve", pika D.

***Nga të dhënat e referuara nga Bashkia Cërrik, në bazë të UMIE nr.446, datë 10.05.2018, pika D, ka një fluks ditor hyrje-dalje prej 1,365 udhëtarësh dhe 498,225 udhëtarë volumi vjetorhyrje-dalje; Sipërfaqja minimale 300 m<sup>2</sup>, etj.***

Bazuar në PPV Cërrik objekti realizohet në parcelën me nën njësinë strukturore 1/11 të PPV Cërrik me kategori bazë të përdorimit të tokës "Banim" si dhe kategori të tjera të lejuara të përdorimit të tokës "Shërbime (S)", "Arsim (AS)", "Shëndetësi (SH)",



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT "NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL".

"Argëtim dhe Rekreacion (AR)" si dhe "Infrastrukturë pa detyrim për hartimin e Planit të Detajuar Vendor", duke mos përjashtuar projektimin dhe ndërtimin e investimit.

Elementë të këtij objekti janë:

1. Sheshi+rrugët e manovrimit+bordura është 2,105m<sup>2</sup>.
2. Objektet funksionale nyjesh sanitar edhe Porteri.
3. Murr rrethues.
4. Brezi gjelbërim, të gjitha këto parametra janë brenda normave të planifikimit.
5. Ndriçimi.

-Projekti fillestar është ndryshuar. Shkaku për ndryshimin e projektit, rezulton se gjatë zbatimit të projektit bashkia ka hasur në kundërshtimin e banorëve të 3 pallateve që gjenden në këtë bllok të cilët nuk kanë dashur/lejuar realizimin e këtij investimi, brenda një blloku banimi.

-Pas dëgjësës publike me banorët e këtyre tre pallateve nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Kryetari i Bashkisë Cërrik, me vendimin nr. 197/1 prot, datë 29.05.2019, ka urdhëruar hartimin e ndryshimeve në projekt me qëllim heqjen e funksionit të këtij projekti nga ndërtim Terminali në parkim publik për autovetura, gjelbërim dhe ndriçim, pra kthimin e këtij sheshi në shesh funksional për banorët e këtyre pallateve si dhe për banorët e qytetit.

Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka kërkuar nga studio projektuese, hartuese e këtij projekti të bëjë rishikimin e tij në përputhje me funksionin e ri që do të kryejë ky investim, projekt i cili pasi është adoptuar në shesh parkimi publik, lulishte dhe ndriçim, rezulton i miratuar në Këshillin Bashkiak të Bashkisë me vendim nr. 438 prot, datë 18.06.2019 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 279/1 prot, datë 05.07.2019.

Zhvillimi i ri kryhet përgjithësisht në truallin me status juridik shtet me përjashtim të sipërfaqes prej 126.26 m<sup>2</sup> e cila është me status juridik truall dhe objekte në pronësi private.

Rishikimi i projektit është referuar në VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 17 "Ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit" si dhe Rregullores e PPV neni 53 "Sipërfaqe e gjelbërimit publik në Zonë", neni 55 "Ndërtimi i vendparkimeve", si dhe konsiston në:

1. Heqjen e funksionit të tij si terminal;
2. Sistemimin e sipërfaqes dhe kthimin në shërbim të komunitetit dhe qytetit në tërësi;
3. Sipërfaqja totale e zhvillimit ishte 2,540 m<sup>2</sup> bëhet 1,840 m<sup>2</sup>;
4. Është rritur sipërfaqja e gjelbërimit për m<sup>2</sup>/ndërtim (ishte 220 m<sup>2</sup> për 2,540 m<sup>2</sup> terminalin e mëparshëm dhe është bërë 333 m<sup>2</sup> për 1,840 m<sup>2</sup> për zhvillimin e rishikuar);
5. Sipërfaqja e gjelbëruar është e pajisur me ndriçim dhe stola për çlodhjeje;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

6. Sheshi në periudha sezonale do të shfrytëzohet edhe për vendosjen e lodrave për fëmijë si:

makina elektrike, trena elektrik, dëgjesa publike, koncerte etj;

7. Numri maksimal i vendparkimeve është 34 (autovetura) për 80 familje që ndodhen në këtë bllok;

8. Janë parashikuar rrugët hyrëse dhe dalëse nga sheshi në rrugën Nationale Cërrik-Elbasan.

-Për këtë objekt është marrë Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit të Mjedis, në Prill 2019, nga studio “Job Project” shpk, raport i ncjerrë për projektin fillestar “Ndërtim i terminalit të linjave të transportit urban dhe interurban me autobusa të udhëtarëve”, si dhe Leja Zhvillimore nr. 135, datë 17.04.2019, me emërtimin “Ndërtim i terminalit të linjave të transportit urban dhe interurban me autobusa të udhëtarëve”.

-Pas nënshkrimit të kontratës me sipërmarrësin zbatues të projektit dhe ndryshimit të destinacionit të tij të miratuar edhe në Këshillin Bashkiak Cërrik, nga “Ndërtim i terminalit të linjave të transportit urban dhe interurban me autobusa të udhëtarëve” në destinacionin final “Për miratimin e projektit të adoptimit të terminalit të autobusëve në vend-parkimi publik, lulishte dhe ndriçim”, Bashkia Cërrik, duhet të kishte miratuar ndryshimin e emërtimit të lejes zhvillimore, në përputhje me përcaktimit e ligjit nr. 107/2014, datë 01.10.2014 ”Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017, dhe konkretisht, nenit 24 pika 5 dhe 6.

Mos pajisja me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e nenit 38 “Leja e zhvillimit”, të ligjit nr. 107/2014, datë 01.10.2014 (trajtuar më hollësisht në aktkonstatimin nr. 1, datë 13.09.2019).

### **III. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit**

- Sipas Regjistrimit të parashikimit të prokurimeve, dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) me shkresën nr. 18/1 prot, datë 03.01.2018, procedura me objekt “Ndërtim i terminalit të autobusëve” ka qenë programuar për t’u zhvilluar në muajin mars 2018, por zhvilluar në dhjetor 2018.

-Me shkresën nr. 3938/2 prot, datë 19.12.2018 është dërguar për APP, Formulari i Njoftimit të kontratës, botuar nga APP në Buletinin nr. 51. datë 24 Dhjetor 2018.

-Procedura është shtyrë për shkak të monitorimit të kryer nga APP, dërguar me e-mail zyrtar [Koordinimi.App@app.gov.al](mailto:Koordinimi.App@app.gov.al) më datë 24 Dhjetor 2018, administratores së sistemit për Bashkinë Cërrik, duke kërkuar ndryshimin e 8 (tetë) kriterëve të DST.

-Me procesverbalin e datës 28.12.2018, janë miratuar disa ndryshime në dokumentet standarde të tenderit, duke u modifikuar kriteret (pakësuar) si dhe ndryshuar data e



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

dorëzimit dhe hapjes së ofertave, procedura të kryera në zbatim të rekomandimeve të APP.

*Lidhur me dokumentet e këtij tenderi të pasqyruara në sistemin elektronik SEP, janë konstatuar se:*

1. Në pikën 1.3.5 të kapacitetit teknik, në lidhje me stafin, ndër të tjerë, AK ka kërkuar që ofertuesit të disponojnë edhe: “Një inxhinier gjeolog”, kriter ky i cili nuk gjen argumentim edhe pse nga NJP është sqaruar se vendosja e këtij kriteri është bërë për shkak të të qenurit të zonës së Bashkisë Cërrik, pjesë të pellgut ujëmbajtës Dumre-Sulovë dhe rreziqeve të mundshme gjeologjike gjatë zbatimit të punimeve.

*Bazuar në: Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet; Zërat e punimeve të parashikuara në Preventiv; Veprimtaritë dhe detajet e përshkruara në dokumentet teknike të kësaj procedure; ngjashmërinë e profileve të inxhinierëve të ndërtimit dhe hidroteknik në kuptim të punimeve që do të kryhen, arsyetohet se për zbatimin e punimeve apo veprimtarive, do të ishte e mjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierit të ndërtimit.*

*Gjithashtu, për zbatimin e punime për ekzekutimin e kontratës, APP vlerëson se AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari për të cilat do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit gjeolog.*

2. Kriteret e veçanta të vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës në kundërshtim me ligjin. Kjo pasi janë kërkuar në mënyrë të ekzagjeruar:

7 inxhinierë; fabrikë prodhimi betoni dhe linjë për prodhimin e inerteve, si dhe 6 licenca dhe me dhjetëra standarde, kur objekt tenderimi është sistemim sheshi për parkim për 20 ditë për një sipërfaqe prej 1840 m<sup>2</sup>.

*Bazuar në sa më sipër, si dhe në rekomandimin e APP, NJP ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pasi kriteret e vendosur nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që kërkohet të zbatohet.*

3. Megjithëse tenderi është vendosur të zhvillohet me 31.12.2018, financimi është programuar tre vjeçar me shpërndarje: 20% në vitin 2018, 40 % në 2019 dhe 40 % në vitin 2020.

*Likuidimi prej 20 % të kontratës, kur tenderi zhvillohet ditën e fundit të këtij viti, jo vetëm që është pakuptim, por i krijon favore kontraktorit dhe vështirësi financiare bashkisë për të likuiduar në vitin 2019 60% të vlerës së kontratës.*

### **III/a Lidhur me zhvillimin e procedurës, ka rezultuar se:**

Më datë 05.01.2019, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, është bërë hapja e procedurës (brenda afatit ligjorë) dhe është bërë evidentimi i operatorëve pjesëmarrës në procedurë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

Më datë 18.01.2019 është mbajtur Raporti përmbledhës në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit, nga ku është evidentuar se nga 2 operatorë pjesëmarrës është skualifikuar 1 operator dhe është kualifikuar 1 ofertë dhe po më datë 18.01.2018, Titullari i AK me vendimin nr. 153, datë 18.01.2019, ka shpallur fituese ofertën e Bashkimit të Operatorëve “V.” & “F.” shpk, me ofertë me vlerë 11,955,322 lekë pa TVSH me një Diferencë nga fondi limit pa TVSH në vlerën 4 581 lekë nga fondi limit në shumën 11 999 903 lekë, pa TVSH.(11,999,903-11,955.322) Me shkresën nr. 195, datë 10.01.2019 (shtojca 13) është dërguar për APP, Formulari i Njoftimit të fituesit, botuar nga APP në Buletinin nr. 4. Datë 28 janar 2019, ndërsa më datë 23.01.2019, pranë degës së “E.” sha, filiali Cërrrik, shoqëria “J.V “V.” dhe “F.” shpk” ka bërë sigurimin e kontratës për vlerën prej 1,434,639 lekë. Me shkresën nr. 1661 datë 02.05.2019, është lidhur kontrata me BOE “V.” & “F.” shpk për vlerën e ofertës 11,955,322 lekë ose 14,346,385.4 lekë me TVSH, dhe me afat 20 (njëzet) ditë kalendarike. Me shkresën nr. 1662, datë 02.05.2019 (shtojca 18) është dërguar për APP, Formulari i lidhjes së kontratës, botuar nga APP në Buletinin nr. 18. Datë 06.05.2019, ndërsa me shkresën nr. 1661/1 datë 02.05.2019, është lidhur kontrata me mbikëqyrësin e punimeve për vlerën e ofertës 49,950 lekë pa TVSH dhe me afat 20 (njëzet) ditë kalendarike. Lidhur me procedurën e vlerësimit nuk u konstatuan shkelje apo parregullsi në drejtim të vlerësimit ofertave dhe zbatimit të procedurave (trajtuar më hollësisht në aktkonstatimin nr. 1, datë 13.09.2019).

### III/b Mbi realizimin e investimit (zbatimi i projektit)

Nga dosja teknike rezulton se projekti dhe preventivi i objektit “Ndërtim Terminali i autobuzëve”, është hartuar nga shoqëria “D.” shpk në Nëntor 2018. Vlera e preventivit është **11,999,903 lekë** pa tvsh. Në këtë preventiv janë parashikuar 7 kapituj punimesh, me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Punime për prishjen e ndërtesave ekzistuese me vlerë lekë;	516,649
2. Punime për ndërtimin e sheshit të autobusëve me asfalt, me vlerë	8,260,955 lekë
3. Punime për rrethimin e terminalit të autobusëve L=211 ml, me vlerë lekë	1,643,877
4. Ndërtimi i vendrojtës, me vlerë	158,827 lekë
5. Punime për ndërtimin e tualetit, me vlerë lekë	533,083
6. Punime për ndërtimin e rrjetit inxhinierik, me vlerë	404,953 lekë
7. Punime për ndriçimin e jashtëm të terminalit, me vlerë lekë	481,558

Sipas projektit sipërfaqja që zhvillohet është 2136 m<sup>2</sup>, nga të cilat 2080 m<sup>2</sup> sipërfaqe e shtruar me pllaka (në preventiv ky zë është me asfaltobeton) dhe 56 m<sup>2</sup> sipërfaqja e murit rrethues + sipërfaqja e porterisë + nyja sanitare. Sipas azhurnimit topografik të



## KONTROLI I LARTË I SHITIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

objektit, rezulton se distancat nga objektet kufitarë janë 7.6 m me pallatin 5 katësh nga veriu me nr. 87, 14.35 ml me pallatin 5 katësh nga lindja me nr. 85, 6.06 m nga pallati 5 katësh nga juglindja me nr. 86 dhe 1.81 ml nga godina njëkatëshe nga jugu. Nga perëndimi kufizohet nga rruga ekzistuese.

Pas ankesave të qytetarëve dhe VKB-së nr. 438, datë 18.06.2019, është bërë ndryshimi i destinacionit të objektit dhe miratimi i projektit të adoptimit, nga objekti “Ndërtimi i Terminalit të autobuzëve”, në objektin “Vendparkim publik, lulishte dhe ndriçim”.

Projekti dhe preventivi i ripunuar (dhe i miratuar) është hartuar po nga shoqëria “Derbi E” shpk në muajin Qershor 2019.

Vlera e këtij preventivi të ripunuar, pas negocimit për çmimet e reja, është **11,955,291 lekë** pa TVSH. Në këtë preventiv janë parashikuar 10 kapituj dhe konkretisht:

1. Punime për prishjen e ndërtesave ekzistuese me vlerë	451,550 lekë;
2. Punime për ndërtimin e sheshit të parkimit me pllaka, me vlerë	6,594,120 lekë
3. Punime për rrethimin e parkimit L=180 ml, me vlerë	1,143,275 lekë
4. Ndërtimi i vendrojes, me vlerë	160,785 lekë
5. Punime për ndërtimin e tualetit, me vlerë	548,364 lekë
6. Punime për ndërtimin e rrjetit inxhinierik, me vlerë	426,450 lekë
7. Punime për ndriçimin e jashtëm të parkimit, me vlerë	510,035 lekë
8. Punime për gjelbërimin, vendosjen e stolave e koshave, me vlerë	985,504 lekë
9. Rruga hyrëse dhe dalëse në parkim, me vlerë	1,047,420 lekë
10. Punime për vendosjen e sinjalistikës, me vlerë	99,788 lekë

Sipas këtij projekti, sipërfaqja që zhvillohet është 1850 m<sup>2</sup>, nga të cilat 1442 m<sup>2</sup> sipërfaqe e shtruar me pllaka dhe 56 m<sup>2</sup> sipërfaqja e murit rrethues + sipërfaqja e porterisë + nyja sanitare, gjelbërimi me sipërfaqe 329 m<sup>2</sup>. Sipas azhurnimit topografik të objektit, rezulton se distancat nga objektet kufitarë janë 13.13 m me pallatin 5 katësh nga veriu me nr. 87, 16.5 ml dhe 18.7 ml me pallatin 5 katësh nga lindja me nr. 85, 10.08 m nga pallati 5 katësh nga juglindja me nr. 86 dhe 2.22 ml dhe 2.65 ml nga godina njëkatëshe nga jugu. Nga perëndimi kufizohet nga rruga ekzistuese.

Nga krahasimi i këtyre dy projekteve, rezulton se:

- Ka ndryshuar lartësia e murit rrethues nga 1.0 m, në 0.6 m;
- Kanë ndryshuar (janë rritur) distancat ndaj objekteve ekzistuese;
- Është ndryshuar paketa e shtresave të sheshit nga asfalt në pllaka betoni;
- Është shtuar kapitulli i gjelbërimit
- Është shtuar kapitulli i ndërtimit të rrugëve hyrëse-dalëse për në parkim;
- Është shtuar kapitulli i vendosjes së sinjalistikës në parkim.
- Analizat e çmimeve janë marrë sipas manualit të çmimeve për zërat që gjenden në manual dhe janë bërë analizat për ato zëra që mungojnë në manual.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

Nga verifikimi i situacionit pjesor nr. 1, datë 28.04.2019 dhe faturë tatimore datë 03.06.2019, me vlerë **3,991,142 lekë** (likuiduar 3,678,084 lekë), rezulton se janë situacionuar punime si më poshtë:

1. Punime për prishjen e ndërtesave ekzistuese me vlerë	387,690 lekë;
2. Punime për ndërtimin e sheshit të parkimit me pllaka, me vlerë	1,734,000 lekë
3. Punime për rrethimin e parkimit L=180 ml, me vlerë	986,110 lekë
4. Punime për ndërtimin e tualetit, me vlerë	218,152 lekë

Nga auditimi i këtij situacioni dhe verifikimi në objekt, i kryer nga grupi i auditimit në prani edhe të Drejtorit të Planifikimit dhe Rregullimit Territorit, Bashkia Cërrik, ka rezultuar se:

- Janë kryer punimet e murit rrethues, por janë situacionuar zërat e gërmimit të rrethimit, themelit të betonit, murit të betonit, kolonave të betonit dhe hekurbetonit me  $d = 8 \text{ mm}$ , më shumë se sasia e preventivuar në vlerën 270,375 lekë;
  - Është situacionuar punimi i pakryer në kapitullin “Punime për ndërtimin e tualetit”, me vlerë 218,152 lekë;
  - Janë respektuar distancat e parashikuara në projektin e adoptuar.
  - Punimet e ndërtimit janë ndërprerë
- (trajtuar më hollësisht në aktverifikimin nr. 1, datë 13.09.2019).

**Shpjegimet e subjektit të audituar:** Nga Bashkia Cërrik, lidhur me aktkonstamin nr.01, datë 13.09.2019, dhe aktverifikimin nr. 01, datë 13.09.2019, me shkresën nr. 2581, datë 20.09.2019, kanë paraqitur sqarimet shoqëruar me dokumentacionin përkatës, punonjësit apo ish-punonjësit, z. A. T., me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë, znj. E. D., znj. I. Ç., z. A. r D., znj. M. Xh. znj. A. H., znj. E. M. dhe z. F. U. duke sqaruar si vijon:

#### Hartimi i dokumenteve te tenderit:

Përsa i përket zhvillimit të procedurës së prokurimit me llojin: **kërkesë për propozim** ju sqarojmë se procedura “Ndërtimi i terminalit të autobusëve” është me fond limit: 11999903 (njembedhjetë milion e nentëqind e nentëdhjetë e nente mijë e nentëqind e tre) leke pa TVSH. Për këtë arsye në bazë të nenit: 8/a të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Kufijtë monetarë: a. Kufiri i ulët monetar: 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike; Neni 39 Kërkesa për propozime: Kërkesa për propozim, sipas nenit 34 të LPP, është një procedurë prokurimi, e cila përdoret për kontratat me vlerë nën kufirin e ulët monetar, por mbi 800.000 (tetëqindmijë) lekë. Përsa më lart si për çdo procedurë tjetër autoriteti kontraktor ka zbatuar dispozitën e mësipërme ligjore për të vendosur llojin e procedurës së prokurimit.

**Sa i përket kërkesave për kualifikim** duhet theksuar se procedura në fjalë është monitoruar nga APP nëpërmjet të cilave Autoriteti Kontraktor ka bërë dhe modifikimet përkatëse nëpërmjet shtojcës duke shtyrë dhe detyrimisht hapjen e procedurës së prokurimit.

Në seksionin 4 të njoftimit të kontratës ne Dt, Ak ka zgjedhur shënimin “JO” tek kërkesa “Procedurë prokurimi e rishpallur” ndërkohë që kjo procedurë është shpallur më parë si procedure prokurimi me REF- 96257-11-30-2018 e cila është anuluar. Sjellim në



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

vëmendje të AK paraqitjen me saktësi të të dhënave të procedurës së anuluar, në përputhje me kërkesat e DT.

Në rastin konkret ju informojmë se shënimi është thjesht një lapsus ne hartimin e DST por që nuk sjell pasoja për zhvillimin e procedurës.

Në **shtojcë 10 të Dt**, AK ka kërkuar : Operatori ekonomik nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktor/nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontrata të vetëlidhura a në proces për tu lidhur sipas LPP-së I cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës. Një kërkesë e tillë është shfuqizuar me VKM nr.80, datë 14.02.2018” Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ne vijim është shtuar: Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që Brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100% të kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri ne kolaudimin e objektit/ investimit.

Shtojca e mësipërme është pjesë e DST të miratuara me vendim te Agjencisë së Prokurimit Publik, në fuqi në momentin e prokurimit (bashkëngjitur) dhe autoriteti kontraktor nuk mund të bëjë ndërhyrje apo ndryshime në to. Megjithatë në vlerësimin e procedurës është patur parasysh ndryshimi i legjislacionit në fuqi.

Në pikën 1.3.3 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administrator i shoqërisë) drejtues teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 5 vjet. Kriteri për pranim gjatë gjithë kohës së punimeve në objekt të drejtuesit teknik nuk është në përputhje me përcaktimet e kreut I/2. I te Udhëzimit nr.2, Datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku parashikohet si jo I detyrueshëm kushti që drejtuesi teknik të jetë gjithë kohës i pranishëm në kantier për punime deri në 30,000,000 lekë.

Autoriteti kontraktor, pas monitorimit të bërë nga APP, të ardhur me e-mail në datën 24 Dhjetor 2018, ka ndryshuar kriterin e mësipërm me Shtojcë të datës 28.12.2018, me Nr 4044/1 (bashkëngjitur) ka bërë modifikimin e këtij kriteri duke e ndryshuar kërkesën në: Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe te ndjek punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 5 (pese) vjet. Pra kushti që drejtuesi teknik të jetë gjithë kohës i pranishëm në kantier, nuk ka qenë më pjesë e kriterëve për kualifikim.

Në pikën 1.3.4 të kapacitetit teknik AK ka kërkuar: “ Një punësim mesatar i të paktën 90 (nëntëdhjetë ) personave, për periudhën Janar 2018-Nëntor 2018 te vërtetuar me : vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikojë numri I punonjësve për secilin muaj; për periudhën Shtator 2017- Nëntor 2018. Listëpagesa të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën Janar 2018- Nëntor 2018



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

*shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”.*

*Njësia e prokurimit ka argumentuar kërkesën e mësipërme për kualifikim në vendimin për miratimin e kërkesave për kualifikim ku sipas përlllogaritjes së orëve të punës bazuar manualeve të çmimeve të manualeve rezulton si me poshtë:*

*Në pikën 1.3.5 të kapacitetit teknik, në lidhje me stafin, ndër të tjerë AK ka kërkuar që ofertuesit të disponojnë edhe : “Një inxhinier hidroteknik dhe një inxhinier gjeolog”.*

*Sa i përket kësaj pike të konstatimeve ju informojmë se me shtojcë të veçantë është ndryshuar kriteri i mësipërm duke hequr inxhinierin hidroteknik. Sa i përket inxhinierit Gjeolog ju informojmë se zona e bashkisë Cërrik është pjesë e pellgut ujëmbajtës Dumre-Sulovë. Në këtë kuadër roli i inxhinierit gjeolog është të marrë masa për faktorët gjeologjikë që ndikojnë në punimet inxhinierike, si dhe analizën e hollësishme teknike dhe vlerësimit të rreziqeve gjeologjike gjatë zbatimit të punimeve.*

*Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, operatori ekonomik duhet 1/b “Punë të ngjashme deri në një kufi , ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave, është jo me e madhe se dyfishi i vlerësimit të kontratës që prokurohet”, duke kufizuar pjesëmarrjen e biznesit.*

*Ju informojmë se një kriter i tillë nuk ka qënë aspak kufizues. Ai është pjesë e VKM 914 dhe njësia e prokurimit ka cituar termin kufizues për të në vendosjen e kriterëve dhe jo për operatorët ekonomik pjesëmarrës. Një lapsus i tillë është ezauruar në fazën e vlerësimit të ofertave.*

*Kriteret e veçanta të vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës në kundërshtim me ligjin. Kjo pasi janë kërkuar në mënyrë të ekzagjeruar: 90 punonjës, nga të cilët 7 inxhinierë (deri edhe 40 kokore...); 2 kamionë vetshkarkues, 2 mjete germimi me goma; 2 eskavatorë, 2 autobetoniere, 1 autovinc etj, deri edhe fabrike prodhimi betoni dhe linjë për prodhimin e inerteve, si dhe 6 licenca dhe me dhjetëra standarde, kur objekt tenderimi është sistemim sheshi për parkim për 20 ditë për një sipërfaqe prej 1840 m<sup>2</sup>. Bazuar në: Tipologjinë e objektit të kontratës që po prokurohet; zërat e punimeve të parashikuara në preventive; veprimtari dhe detajet e përshkruara në dokumentat teknike të kësaj procedure; ngjashmërinë e profileve të inxhinierëve të ndërtimit dhe hidroteknik në kuptim të punimeve që do të kryhen, arsyetohet se për zbatimin e punimeve apo veprimtarive, do të ishte e mjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierit të ndërtimit. Gjithashtu për zbatimin e punimeve për ekzekutimin e kontratës, APP vlerëson se AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari për të cilat do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit gjeolog. Bazuar në sa më sipër si dhe në rekomandimin e APP, NJP ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 46 të LPP dhe pikës 5 të nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 pasi kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që kërkohet të zbatohet. Gjithashtu në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të*



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

### RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

hartuara nga NJHDT, pasi për të gjitha kriteret e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, sic kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, pasi hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe cdo informacion tjetër, duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht.

Kërkesat për kualifikim, pjesë e DST janë argumentuar dhe miratuar nga ana e njësisë së prokurimit me vendimin datë 19.12.2019 pjesë e dosjes së prokurimit (bashkëngjitur). Ashtu siç theksuam me lart ka patur një monitorim nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik sugjerimet e së cilës janë marrë parasysh dhe në pjesën tjetër janë argumentuar siç kemi theksuar në shpjegimet e mësipërme. Cdo kërkesë për kualifikim ka qënë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me natyrën e objektit që prokurohej.

Në piken 1.3.14 të kapacitetit teknik Ak ka kërkuar: në rast të bashkimit të dy operatorëve secili prej anëtareve të bashkimit duhet të ketë certifikatën ISO të kërkuar. Një kriter i tillë është në kundërshtim me nenin 74, pika 3 të VKM-se nr.914, datë 29.12.2014, pasi në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata ISO sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshje.

ISO-t e vendosura nga njësia e prokurimit janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. ISO-t standarde janë kërkuar për operatorët si një detyrim i plotësisht të kërkesave të cilësisë për cdo operator ofertues ndërsa për ISO 39001:2012 (Standard për sistemin e menaxhimit të sigurisë rrugore) (e vlefshme) dhe ISO 8000:2014 mbi (Sisteme të menaxhimit të pergjegjshmerisë sociale) (e vlefshme) është kryer modifikimi i kërkesave për kualifikim nëpërmjet shtojcës përkatëse duke theksuar se në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Anullimi i procedurës së prokurimit I bërë nga ana juaj për ndryshim të DT (pika 1.3.15 të kapacitetit teknik, përfshirë këtu dhe kriteret për kualifikim ) nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 42 të LPP-së pasi mund të behën ndryshimet përkatëse përmes hartimit të një shtojce, e cila ju vihet në dispozicion operatorëve ekonomikë në DST e publikuara në SPE.

Në rastin konkret nuk është anuluar procedura e prokurimit por është bërë modifikimi i kërkesave për kualifikim.

Megjithëse tenderi është vendosur të zhvillohet më 31.12.2018, financim është programuar tre vjecar me shpërndarje : 20% në vitin 2018, 40% në vitin 2019, 40% në vitin 2020. Likuidimi prej 20% të kontratës, kur tenderi zhvillohet ditën e fundit të këtij viti, jo vetëm që është pakuptim, por I krijon favore kontraktorit dhe veshtirësi financiare bashkisë për të likuiduar në vitin 2019 60% të vlerës së kontratës.

Fondi i përcaktuar për këtë objekt sic do fond tjetër I programuar në masën 20% nuk mund të përdoret për objekte të tjerë ndaj ai transferohet në vitin pasardhës. Për këtë arsye nuk ka asnjë favorizim dhe as shkelje kontraktuale sipas përcaktimeve paraprake të DST.

Zhvillimi i procedurës:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

*Përsa i përket vërtetimit nr. 24071/1 datë 28.12.2019 në të cilën vërtetohet se, nuk rezulton debitor në sistemin e faturimit për kontratën TR35050396626934, titullar I të cilës është D..*

*Ju informojmë se në rastin konkret operatori ekonomik F. sh.p.k. ka një kontratë qiraje për zyra në një kompleks të dezignuar për zyra (për operatore privatë etj) Titullar I së cilës është D.(bashkëngjitur)*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** nga grupi i auditimit janë marrë parasysh pothuajse të gjitha sqarimet e paraqitura nga bashkia, me përjashtim të disa kritereve të miratuara nga NJP dhe konkretisht:

Në pikën 1.3.5 të kapacitetit teknik, në lidhje me stafin, ndër të tjerë, AK ka kërkuar që ofertuesit të disponojnë edhe: “Një inxhinier gjeolog”, kriter ky i cili nuk gjen argumentim edhe pse nga NJP është sqaruar se vendosja e këtij kriteri është bërë për shkak të të qenurit të zonës së Bashkisë Cërrrik, pjesë të pellgut ujëmbajtës Dumre-Sulovë dhe rreziqeve të mundshme gjeologjike gjatë zbatimit të punimeve.

*Bazuar në: Tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet; Zërat e punimeve të parashikuara në Preventiv; Veprimtaritë dhe detajet e përshkruara në dokumentet teknike të kësaj procedure; ngjashmërinë e profileve të inxhinierëve të ndërtimit dhe hidroteknik në kuptim të punimeve që do të kryhen, arsyetohet se për zbatimin e punimeve apo veprimtarive, do të ishte e mjaftueshme ekspertiza profesionale e inxhinierit të ndërtimit.*

*Gjithashtu, për zbatimin e punime për ekzekutimin e kontratës, APP vlerëson se AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari për të cilat do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit gjeolog.*

Kriteret e veçanta të vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës në kundërshtim me ligjin. Kjo pasi janë kërkuar në mënyrë të ekzagjeruar: 7 inxhinierë; fabrikë prodhimi betoni dhe linjë për prodhimin e inerteve, si dhe 6 licenca dhe me dhjetëra standarde, kur objekt tenderimi është sistemim sheshi për parkim për 20 ditë për një sipërfaqe prej 1840 m<sup>2</sup>.

### V. Përmbledhje e konstatimeve (shkelje dhe parregullsi)

- ✓ Pasuritë mbi të cilat do të realizohet investimi rezultojnë në pronësi shtet, kryesisht të emër të bashkisë, por dhe të papërcaktuara, kjo për shkak të realizimit të pasaktë të procesit të inventarizimit të pronave publike dhe shtetërore. Pronat figurojnë në zërin “Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji”, dhe lloji i transferimit “Në përdorim”.
- ✓ **Pasuritë e kaluara në pronësi, nuk figurojnë të regjistruara në emër të Bashkisë Cërrrik.**
- ✓ Pas procesit të inventarizimit dhe kalimit në pronësi, mbi pronën objekt zhvillimi, ka vepruar edhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave dhe Ndërtimeve Informale, duke bërë legalizimin e disa trojeve dhe objekteve të ndërtuara pa leje, çka ka sjell për pasojë edhe pezullimin e procesit të zbatimit të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

investimit, pasi rezulton se me konfirmimin nga ZVRPP Elbasan të ekzistencës së titujve të pronësisë, bashkia ka filluar procedurat e shpronësimit për interes publik të trojeve dhe objekteve (edhe pse ato çenojnë në një masë shumë të vogël investimin), detyrim ky i përcaktuar nga ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe akteve të dala në zbatim të këtij ligji.

- ✓ Projekti fillestar është ndryshuar. Shkaku për ndryshimin e projektit, rezulton se gjatë zbatimit të projektit bashkia ka hasur në kundërshtimin e banorëve të 3 pallateve që gjenden në këtë bllok të cilët nuk kanë dashur/lejuar realizimin e këtij investimi, brenda një blloku banimi.
- ✓ Zhvillimi i ri kryhet përgjithësisht në truallin me status juridik shtet me përjashtim të sipërfaqes prej 126.26 m<sup>2</sup> e cila është me status juridik truall dhe objekte në pronësi private, çka nuk është marrë parasysh nga bashkia.
- ✓ -Pas nënshkrimit të kontratës me sipërmarrësin zbatues të projektit dhe ndryshimit të destinacionit të tij të miratuar edhe në Këshillin Bashkiak Çërrik, nga “Ndërtim i terminalit të linjave të transportit urban dhe interurban me autobusa të udhëtarëve” në destinacionin final “Për miratimin e projektit të adoptimit të terminalit të autobusëve në vend-parkimi publik, lulishte dhe ndriçim”, Bashkia Çërrik, duhet të kishte miratuar ndryshimin e emërimit të lejes zhvillimore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 107/2014, datë 01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar me ligjin nr. 73/2015, datë 09.07.2015, nr. 8/2017, datë 23.03.2017, dhe konkretisht, nenit 24 pika 5 dhe 6. Mos pajisja me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e nenit 38 “Leja e zhvillimit”, të ligjit nr. 107/2014, datë 01.10.2014.
- ✓ Kriteret e veçanta të vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës në kundërshtim me ligjin. Kjo pasi janë kërkuar në mënyrë të ekzagjeruar:
- ✓ 7 inxhinierë; fabrikë prodhimi betoni dhe linjë për prodhimin e inerteve, si dhe 6 licenca dhe me dhjetëra standarde, kur objekt tenderimi është sistemim sheshi për parkim për 20 ditë për një sipërfaqe prej 1840 m<sup>2</sup>.
- ✓ Megjithëse tenderi është vendosur të zhvillohet me 31.12.2018, financimi është programuar tre vjeçar me shpërndarje: 20% në vitin 2018, 40 % në 2019 dhe 40 % në vitin 2020. Likuidimi prej 20 % të kontratës, kur tenderi zhvillohet ditën e fundit të këtij viti, jo vetëm që është pakuptim, por i krijon favore kontraktorit dhe vështirësi financiare bashkisë për të likuiduar në vitin 2019 60% të vlerës së kontratës.
- ✓ Nga verifikimi i situacionit pjesor nr. 1, datë 28.04.2019 dhe faturë tatimore datë 03.06.2019, rezulton se janë situacionuar punime me vlerë **3,991,142 lekë** (likuiduar 3,678,084 lekë), ndërsa nga verifikimi në objekt, i kryer nga grupi i auditimit në prani edhe të Drejtorit të Planifikimit dhe Rregullimit Territorit,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

Bashkia Cërrik, ka rezultuar se Është situacionuar punimi i pakryer në kapitullin “Punime për ndërtimin e tualetit”, me vlerë 218,152 lekë;

✓ Punimet e ndërtimit janë ndërprerë.

### **Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave të mëposhtme:**

**Rekomandimi nr. 1:** Bashkia Cërrik, nisur nga ndryshimi i emërimit të objektit, i cili do të funksionojë si “Vendparkim publik, Relulishte dhe ndriçim”, ndërtimi i tualeteve me vlerë të preventivuar 542,889 lekë, mund të konsiderohet e tepërt dhe bashkia mund të rivlerësoj vendosjen e tyre, pavarësisht punimeve nëntokësore (instalimeve). Kjo nisur dhe nga mospranimi nga komuniteti për ndërtimin e Tualeteve në takimin e zhvilluar në Bashkinë Cërrik më datën 03.09.2019.

*Menjëherë*

**Rekomandimi nr. 2:** Bashkia Cërrik, nisur nga ndryshimi i emërimit dhe destinacionit të objektit të shikohet mundësia e ndryshimit të kangjellave (zvogëlimit të lartësisë).

- Pas ripunimit të preventivit për zërat e sipërcituar, të shikohet mundësia e rritjes së sipërfaqes së gjelbëruar dhe vendosjes (shtimin) e stolave për komunitetin, duke zëvendësuar volumin e punimeve për rrethimin e objektit (zëri nr. 3, Punime për rrethimin e parkimit L=180 ml, me vlerë 1,143,275 lekë).

*Menjëherë*

**Rekomandimi nr. 3:** Bashkia Cërrik ka situacionuar më tepër se punimet e kryera në fakt shumë prej 488,527 lekë, vlerë e cila duhet të mbahet në konsideratë në momentin e hartimit të situacionit përfundimtar nga ana e shoqërisë zbatuese të projektit “V.” & “F.” shpk.

*Menjëherë*

**Rekomandimi nr. 4:** Bashkia Cërrik, të vijojë zbatimin e detyrimit ligjor të procesit të shpronësimit për interes publik të pronave dhe pronarëve të trojeve dhe objekteve të ndodhura mbi sipërfaqen objekt investimi (për ato prona të cilat disponohet titull pronësor i lëshuar nga Zvrpp Elbasan, sot ASHK, Drejtoria Rajonale Elbasan) procedura në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, dhe akteve të dala në zbatim të këtij ligji.

*Menjëherë*

**Rekomandimi nr. 5:** Bashkia Cërrik të vijojë me përditësimin e listës të inventarit të pasurive, duke përfshirë edhe ato parcela të cilat sot rezultojnë në zërin pronë shtet, si dhe paraqitjen për miratim të tyre në Këshillin Bashkiak dhe më tej dërgimin në Ministrinë e linjës për përditësimin e VKM-së nr. 573, datë 28.05.2019 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Cërrik, të Qarkut të Elbasanit”.

*Menjëherë*

**Rekomandimi nr. 6:** Bashkia Cërrik, pas përditësimit dhe miratimit të listës së inventarit për pasuritë objekt investimi, të aplikojë në ASHK Drejtorinë Rajonale Elbasan, me qëllim regjistrimin e truallit objekt zhvillimor dhe pajisjen me Certifikatë Pronësie.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT TEMATIK PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TIRANË MBI REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI, RIKONSTRUKSION DHE RINOVIMI I UNAZËS SË VOGËL”.

*Menjëherë*

**Rekomandimi nr. 7:** Bashkia Cërrik, Kryetari i Bashkisë me Drejtorinë e Planifikimit dhe Rregullimit Territorit, të miratoj ndryshimin e lejes zhvillimore sipas destinacionit final të saj, nga “Ndërtim i terminalit të linjave të transportit urban dhe interurban me autobusa të udhëtarëve” në “Për miratimin e projektit të adoptimit të terminalit të autobusëve në vend-parkimi publik, lulishte dhe ndriçim”, Bashkia Cërrik, në zbatim të nenit 38 “Leja e zhvillimit”, të ligjit nr. 107/2014, datë 01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

*Menjëherë*

*Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi Tematik Përputhshmërie.*

### GRUPI I AUDITIMIT

**N. N.**

**Gj. P.**

**A. Z.**

**R. XH.**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**